

NJOFTIM PËR SHTYP

Takimi i 13-të i Nënkomiteti BE-Shqipëri mbi Bujqësinë dhe Peshkimin Videokonferencë - Bruksel/Tiranë, 2 dhjetor 2021

Përfaqësues nga Komisioni Evropian (Komisioni) dhe Shqipëria zhvilluan diskutime më 2 dhjetor 2021 mbi nivelin e zbatimit të MSA-së dhe të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së në fushën e bujqësisë dhe peshkimit, duke përfshirë çështjet e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. Takimi u bashkëkryesua për palën shqiptare nga Znj. Ermira Gjeci, Zëvendës Ministre për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe për BE-në nga Z. Alberto Cammarata, Zëvendës Përgjegjës i Njësisë për Shqipërinë dhe Bosnjë Hercegovinën në Drejtorinë e Përgjithshme të Fqinjësisë dhe Negociatave të Anëtarësimit.

Në takim, palët diskutuan mbi zhvillimet për këto fusha dhe shkëmbyen statistika të detajuara tregtare për tregtinë e produkteve bujqësore bazë dhe të përpunuara, si dhe produkteve të peshkimit. Nën objektin e këtij Nënkomiteti, Komisioni theksoi nevojën që Shqipëria të ketë strategji të fuqishme sektoriale për të tre sektorët dhe të sigurojë kapacitete të përshtatshme administrative në të gjithë sektorët. Strategjitë e fuqishme sektoriale të lidhura me procesin e duhur të buxhetimit janë gjithashtu thelbësore për zbatimin e suksesshëm të IPA III. Komisioni ftoi Shqipërinë të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e tij të vendit 2021.

Për sa i përket bujqësisë dhe zhvillimit rural, Komisioni përshëndeti përpjekjet e autoriteteve shqiptare në zbatimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit për Zhvillimin Rural (IPARD - programi i zhvillimit rural i financuar nga BE). Komisioni theksoi nevojën për të shqyrtuar mundësitë për zgjerimin e fushës së Programit IPARD II me masa shtesë. Ai gjithashtu theksoi nevojën për të siguruar burime të përshtatshme njerëzore për zbatimin e programit IPARD III në një mënyrë efektive dhe plotësisht transparente.

Komisioni i kërkoi sërish Shqipërisë të krijojë regjistrin e fermerëve dhe të përmirësojë cilësinë e të dhënave në regjistrin e kafshëve. Të dy regjistrat janë kyç për përcaktimin e politikave kombëtare, duke përfshirë çështjet veterinare, si dhe për zbatimin e qetë dhe të suksesshëm të IPARD. Komisioni inkurajoi gjithashtu Shqipërinë që të kryejë regjistrimin e ardhshëm të pronave bujqësore (CAH) në 2023.

Në fushën e sigurisë ushqimore, çështjeve veterinare dhe fitosanitare, është e një rëndësie të veçantë që vendi të përfundojë dhe zbatojë reformën në sektorin veterinar dhe të intensifikojë monitorimin dhe mbikëqyrjen në kontrollin e sëmundjeve të kafshëve. Komisioni e ftoi Shqipërinë të vazhdojë përafrimin e legjislacionit të saj në këto fusha me zhvillimet më të fundit të *acquis* të BE-së, si dhe të sigurojë gjurmueshmëri të plotë në të gjithë zinxhirin ushqimor.

Për sa i përket peshkimit, Komisioni pranoi progresin e mirë në sektorin e peshkimit, veçanërisht në lidhje me sistemin e monitorimit të anijeve (VMS) i cili u rivendos dhe është plotësisht funksional që nga maji 2021. Komisioni shprehu kënaqësinë e tij për bashkëpunimin shumë konstruktiv me Shqipërinë brenda kuadrit të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) dhe ftoi Shqipërinë të vazhdojë zbatimin e rekomandimeve të GFCM, veçanërisht në lidhje me planin e menaxhimit të peshkimit fundor për vitin 2022 dhe planin shumëvjeçar të menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të rezervave të vogla pelagjike të peshkut në detin Adriatik.